QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT
Nr. 10178 Prot.
Datë 10. 11. 2020

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**MINISTRIA E DREJTESISE**
**PERMBARUES GJYQESOR PRIVAT NERITAN ÇUKO**


Adresa: Lagjia "29 Nentori", Rr. "Dervish Hekali", kati I 2, pallati prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Fier, Fier, Kutia Postare Nr.2948, Tirane,
Cel: Neritan Çuko: 0686065334; E-mail: neritancuko@gmail.com


**Nr. 696 Regj.** **Fier, me 04.11.2020**

**U R D H Ë R**

**"PËR VËNIEN E SEKUESTROS MBI PASURINE E DEBITORIT"**

**Drejtuar : QENDRES KOMBETARE TË REGJISTRIT TREGTAR, TIRANE.**
**Adresa : Blv. "Zhan D'Ark", ish Hoteli i Oficerave, Tirane.**

**Per dijeni pales debitorit/ve : Shoqerise "HIDA Construction" Sh.p.k me NIPT L72022031A, me Administrator/e Z.Florjand Hida**
**Adresa : Njesia Bashkiake Nr.1, Rr. "Shemsi Haka", Banese Private Nr.158, Tirane Cel: 0697388895**
**Per dijeni kreditorit : Shoqeria "ROFIX" Sh.p.k., me NIPT J81804007E, me Administrator/e Znj. Aurora Bilali**
**Adresa : Nikel Tapize 1504, Durres, Shqiperi**

Pranë zyrës së Përmbarimit Gjyqësor Privat të Z. Neritan ÇUKO, me kërkesë të palës kreditore është regjistruar çështja përmbarimore me numër 696 dhe me palë :
**Kreditor : Shoqeria "ROFIX" Sh.p.k., me NIPT J81804007E, me Administrator/e Znj. Aurora Bilali**
**Debitorit/ve : Shoqerise "HIDA Construction" Sh.p.k me NIPT L72022031A, me Administrator/e Z. Florjand Hida**
**Me objekt : Detyrim pagim shume si dhe pagesat e kamatevonesave**

**KONSTATOVA:**

**Në titullin ekzekutiv Fatura Tatimore Shitjeje me nr. 78, date 22.01.2019, me nr. 161, date 30.01.2019, me nr. 225, date 06.02.2019, me nr. 1006, date 16.04.2019, me nr. 3560, date 11.11.2019, me nr. 3755, date 27.11.2019, me nr. 3362, date 17.12.2019, me nr. 3384, date 19.12.2019, me nr. 3405, date 22.12.2019, me nr. 3424, date 26.12.2018, me nr. 3428, date 26.12.2018, me nr. 3458, date 28.12.2019, me nr. 3465, date 28.12.2019, me nr. 28, date 15.01.2018 per te cilat Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane, ka leshuar Urdheri i Ekzekutimit Nr. 4466, date 15.09.2020, ku është vendosur detyrimi i juaj:**

- Pranimin e kerkeses
- Leshimin e urdherit te ekzekutimit per faturat tatimore te shitjes: nr. 78, date 22.01.2019, me nr. 161, date 30.01.2019, me nr. 225, date 06.02.2019, me nr. 1006, date 16.04.2019, me nr. 3560, date 11.11.2019, me nr. 3755, date 27.11.2019, me nr. 3362, date 17.12.2019, me nr. 3384, date 19.12.2019, me nr. 3405, date 22.12.2019, me nr. 3424, date 26.12.2018, me nr. 3428, date 26.12.2018, me nr. 3458, date 28.12.2019, me nr. 3465, date 28.12.2019, me **nr. 28,** date 15.01.2018, te leshuar nga Kreditori Shoqeria "Rofix" Shpk per subjektin "HIDA Construction"Shpk me seli ne Rr. Shemsi Haka, Nr.158, Tirane me NIPT L72022031A, mbi Shumen e faturave te perllogariten nga permbaruesi gjyqesor ne fazen e ekzekutimit, kamatat ligjore ne perputhje me Nenin 5 te Ligjit Nr.48/2014 dt.24.04.2014.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
PERMBARUES GJYQESOR PRIVAT NERITAN ÇUKO

Adresa: Lagjia "29 Nentori", Rr. "Dervish Hekali", kati 12, pallati prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Fier, Fier, Kutia Postare Nr.2948, Tirane,
Cel: Neritan Çuko: 0686065334; E-mail: neritancuko@gmail.com

- Ngarkohet Sherbimi Permbarimor te beje ekzekutimin e titullit ekzekutiv.
- Kunder ketij vendimi nuk lejohet ankim sipas ligjit.
- Shpenzimet gjyqesore ne ngarkim te kerkueses.

Nëpermjet shkreses me nr. 696 regj. te dates 16.10.2020, per te cilen Ju keni marre dijeni, për kryerjen e ekzekutimit në mënyrë vullnetare, por nga ana e juaj nuk është vepruar për ekzekutimin e titullit dhe në bazë dhe nenit 519 të K.Pr.Civile ka kaluar në ekzekutim të detyrueshëm.

**Për ketë në bazë të ligjit duhet të kryhet sekuestrimi i pasurisë së luajtshme i vleres prej 100% te aksioneve në pronësi te te debitorit shoqerise Shoqerise "HIDA Construction" Sh.p.k me NIPT L72022031A, me Administrator/e Z. Florjand Hida, me qëllim shlyerjen e detyrimit kundrejt pales kreditore.**

**Për ketë arsye : Në bazë të neneve 527, 560, 563 e në vijim të K.Pr.Civile**

**URDHËROJMË**

- **Vendosjen e masës së sekuestros, mbi pasurinë e luajtshme i vleres prej 100% te aksioneve te tashme dhe te ardheshme në pronësi te shoqerise Shoqerise "HIDA Construction" Sh.p.k me NIPT L72022031A, me Administrator/e Z. Florjand Hida, duke perfshire edhe aksionet ne te cilat shoqeria mund te behet aksionere, me qëllim shlyerjen e detyrimit kundrejt pales kreditore.**
- Pasuria e sipercituar te vendoset në sekuestro deri ne shlyerjen e plote te detyrimit.
- Bashkengjitur keni edhe dokumentacionin perkates.
- Për veprimin apo mosveprimin tuaj,duhet të na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
- Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhri do të merren masat e parashikuara në neni 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vënd do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.
- Ky urdhër ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.C kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor brenda 5 ditëve nga marrja dijeni.

**PËRMBARUESI GJYQËSOR PRIVAT**
**Neritan ÇUKO**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NERITAN A.ÇUKO
PERMBARUES GJYQESOR PRIVAT

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR**
**TIRANË**

**Nr.4466 akti**
**Date .04.09.2020**

**Date 15.09.2020**

**VENDIM**
**"Urdher Ekzekutimi"**
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë prej:
**GJYQTAR : Arben Kostandini**
sot më dt.15.09.2020 mori në shqyrtim në dhome keshillimi çështjen civile që i përket:

**KERKUES:** ''Rofix''shpk, regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit me NIPT J81804007E, me seli te ushtrimit te aktivitetit ne adresen: Nikel Tapize 1504, Durres, Shqiperi, perfaqesuar nga Av. Brikena Duda me autorizim date 25.08.2020.

**OBJEKTI:** Leshimi i urdherit te ekzekutimit per detyrimin qe rrjedh nga Faturat Tatimore te Shitjeve: nr. 78, date 22.01.2019; nr. 161, date 30.01.2019; nr. 225 date 06.02.2019; nr. 1006 date 16.04.2019; nr.3560, date 11.11.2019; nr.3755, date 27.11.2019; nr. 3362, date 17.12.2019; nr.3384, date 19.12.2019; nr. 3405, date 22.12.2019; nr. 3424, date 26.12.2018; nr.3428, date 26.12.2018; nr. 3458 date 28.12.2018; nr. 3465 date 28.12.2018; nr. 28 date 15.01.2018

**BAZA LIGJORE**: Neni 16 i Ligjit Nr. 48/2014 Per Pagesat e Vonuara ne Detyrimet Kontraktore e Tregtare ,Nenet 510/e dhe 511 te K.Pr.Civile, i ndryshuar).

Gjykata pasi çmoi provat e paraqitura dhe shqyrtoi çeshtjen civile ne teresi;

**VEREN**

Pala kerkuese Shoqeria ''Rofix''shpk, eshte person juridik i rregjistruar prane Qendres Kombetare te Bisnesit dhe ushtron aktivitetin ne fushen prodhimin dhe tregtimin e materialeve per ndertim, imporamin dhe eksportimin e te gjitha materialeve perberese ne sektorin e ndertimit etj ......
Mes kerkuesit Shoqeria ''Rofix''shpk dhe , Shoqeris ''HIDA Construction ''shpk ka patur nje marrdhenie tregetare furnizimi me material ndertimi te gatshme e gjysem te gateshme sipas kerkeses se saj . Per kete pala kërkuese rezulton të ketë lëshuar kundrejt subjekti ''Gjoka –AL Ndertim ''shpk fatureat tatimore te shitjes nr. 78, date 22.01.2019; nr. 161, date 30.01.2019; nr. 225 date 06.02.2019; nr. 1006 date 16.04.2019; nr.3560, date 11.11.2019; nr.3755, date 27.11.2019; nr. 3362, date 17.12.2019; nr.3384, date 19.12.2019; nr. 3405, date 22.12.2019; nr. 3424, date 26.12.2018; nr.3428, date 26.12.2018; nr. 3458 date 28.12.2018; nr. 3465 date 28.12.2018; nr. 28 date 15.01.2018 sipas objektit te kerkimit.
Sipas kerkimit të palës kërkuese nga ana e subjekti ''HIDA Construction ''shpk nuk rezulton që të jetë përmbushur detyrimi për pagimin e çmimit të përcaktuar në faturat tatimore të shitjes të sipërcituar dhe për këtë shkak lidhur me keto fatura tatimore kerkuesi kerkon lëshimin e urdhërit


REPUBLIKA E SHQIPERI
NERITAN A. ÇUK
-PERM

te ekzekutimit si dhe kamatat në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare",

Nisur nga sa u parashtrua më lart, çështja që do të merret në shqyrtim në rastin konkret nga ana e gjykatës është :

*I. Nëse ekzistojnë apo jo kushtet për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për faturen tatimore të shitjes të lëshuara nga ana e kerkuesit në kuptim kjo të nenit 16 të ligjit nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare"?*

I. Lidhur me çështjen e shtruar për shqyrtim :

Në nenin 16 të ligjit nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare", dispozitë kjo e emërtuar : *"Titulli ekzekutiv"* parashikohet shprehimisht se :

*"1. Detyrimet monetare, të lindura nga veprimet juridike tregtare, të cilat nuk janë shlyer brenda afatit të pagesës përkatëse, sipas këtij ligji, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 485 i Kodit Civil, përbëjnë titull ekzekutiv dhe vihen ne ekzekutim nga përmbaruesi gjyqësor, pavarësisht vlerës, kur:*

*a) kreditori ka lëvruar mallrat apo kryer shërbimet sipas kontratës dhe ligjit; dhe*

*b) debitori nuk e ka kundërshtuar detyrimin.*

*2. Në këto raste, detyrimi së bashku me kamatëvonesat dhe me shpërblimin për shpenzimet për rikthimin e kredisë mund të vihen në ekzekutim të detyrueshëm, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile".*

Neni 511 i K. Pr. Civile i ndryshuar me Ligjin Nr. 114/2016 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8116, datë 29.3.1996, "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë dhe

Në nenin 510 gërma "e" të K.Pr.Civile parashikohet shprehimisht se *konsiderohen tituj ekzekutivë të gjitha aktet e tjera që sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutivë dhe ngarkohet Zyra e Përmbarimit për ekzekutimin e tyre.*

Kjo kërkesë u mor në shqyrtim nga Gjykata në Dhomë Këshillimi pa prezencën e palës kërkueses, e cila në marrjen e vendimit shqyrtoi vetëm aktet e bashkangjitur kërkesës.

Sipas akteve të administruara në gjykim rezultoi se ;

Në rastin konkret në zbatim të dispozitave të sipërcituara rezulton që të plotësohen kushtet për t'i konsideruar faturat tatimore të shitjes të lëshuar nga ana e kerkuesit përkundrejt "HIDA Construction "shpk si titull ekzekutiv për detyrimin per arsye se :

**Së pari:** Pala kërkuese rezulton ta ketë ofruar shërbimin subjekti "HIDA Construction "shpk .

**Së dyti :** Nuk rezulton që subjekti "HIDA Construction "shpk të ketë kundërshtuar furnizimin e ofruara nga ana kerkuesit.

**Së treti :** Nuk rezulton që të jemi në kushtet e përcaktimeve të nenit 485 të K.Civil.

**Së katërti :** Në kuptim të përcaktimeve të nenit 16 të ligjit nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare", fatura tatimore e shitjes të lëshuara nga ana e kerkesit rezulton që në kuptim të dispozitës së sipërcituar të konsiderohen tituj ekzekutivë, për zbatimin e të cilave ngarkohet shërbimi përmbarimor.Gjitashu ne baze te nenit 5 e 12 te Ligjin nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare" duhet te paguhen dhe kamatvonesat dhe gjobat.

**PER KETO ARSYE**

Ne referim te neneve 510 - 511 te K. Pr. Civile

**VENDOSI**

-Pranimin e kërkesës.

-Lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për faturen tatimore shitjes nr. 78, date 22.01.2019; nr. 161, date 30.01.2019; nr. 225 date 06.02.2019; nr. 1006 date 16.04.2019; nr.3560, date 11.11.2019;


REPUBLIKA E SHQIPËRIS
NE RRITAN A. ÇUK
ZËR-PËF

nr.3755, date 27.11.2019; nr. 3362, date 17.12.2019; nr.3384, date 19.12.2019; nr. 3405, date 22.12.2019; nr. 3424, date 26.12.2018; nr.3428, date 26.12.2018; nr. 3458 date 28.12.2018; nr. 3465 date 28.12.2018; nr. 28 date 15.01.2018 leshuar nga Kreditori Shoqeria ''Rofix''shpk per subjekti ''HIDA Construction ''shpk me seli ne Rr.''Shemsi Haka ''Nr.158 Tirane me NIPT L72022031A, mbi shumen e faturave te perllogariten nga permbaruesi gjyqesor ne fazen e ekzekutimit, kamatat ligjore ne perputhje me Nenit 5 te Ligjit Nr. 48/2014 dt.24.04.2014.
-Ngarkohet Sherbimi Permbarimor të bëjë ekzekutimin e titullit ekzekutiv.
Shpenzimet gjyqësore ne ngarkim te kerkuese.
***-U shpall ne Tirane, sot me date 15.09.2020***

**GJYQTAR**

**ARBEN KOSTANDINI**

SHPENZIMET GJYQSORE
Takse pulle 200 Leke

PULLE TARIFE
200 LEKE
R.SHQIPERISE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NERITAN A. ÇUKO
PERM... ESOR PRIVAT